



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 33, dt. 23.02.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 23.02.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit lidhur me punimet e sistemimit përgjatë objektit “Godinë polifunksionale 7 kat me 4 kate parkim nëntokë”, në pjesën e pedonale të rrugës “Abdi Toptani”, Tiranë, me kushtin:
Ndërhyrjet rehabilituese në pedonalen “ Abdi Toptani ” të bëhet për të gjithë elementet përbërës në gjithë gjatësinë e saj nga ana e investitorëve.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

KRYETAR
MIRELA KUMBARO TURXHI

